

Prot. Nr. 5041200697/
1

**AKT THEMELIMI I
SHOQËRISË “SOLAR LOGISTIC” SHPK**

Sot, më 01.09.2023, ortaku i mëposhtëm themelues:

- 1) Shoqëria “Interlogistic shpk., me Nr.NIPT K21605003M me seli në Tiranë, Kashar, Autostrada Tiranë- Durrës, Rruga Dytësore, Km 9, Godina 3-katëshe, përfaqësuar nga Administratori Z. Edmond HIDO.

i cili me vullnet të plotë, të lirë e të pacënuar, nënshkruan këtë Akt Themelimi, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nëpërmjet të cilit Ortaku Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë “SOLAR LOGISTIC” SHPK, me kushtet si më poshtë vijon:

**NENI 1
Emri i shoqërisë**

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “SOLAR LOGISTIC” SHPK.
- 1.2. Ortaku Themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë.

**NENI 2
Forma e shoqërisë**

- 2.1. Forma e shoqërisë tregtare “SOLAR LOGISTIC” SHPK (*referuar në vijim si “Shoqëria”*) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3
Selia e shoqërisë**

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Autostrada Tiranë- Durrës, Rruga Dytësore, km 9, ZK. 2119, Pas. Nr. 148/46, Godina 3-katëshe, Kashar, Tiranë.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë.



NENI 4
Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar, i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, nëpërmjet një vendimi të posaçëm.

NENI 5
Objekti i veprimtarisë


- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare dhe energjisë së erës në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministritë e Institucionet të Shtetit Shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rrinovueshme nga dielli, era, uji etj. Ndërtimi i hidrocentraleve, prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike etj. Tregtimi i energjisë nga burime të rrinovueshme. Import - eksport, projektim, instalim, supervizim, mirëmbajtje etj.

NENI 6
Kapitali dhe Kuotat e Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i Shoqërisë është në vlerën ALL 100,000 (njëqindmijë lekë).
6.2. Kapitali bazë i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, e cila zotërohet nga Ortaku Themelues, shoqëria "Interlogistic" shpk me vlerë nominale prej ALL 100,000 (njëqindmijë lekë), e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% (njëqind përqind) në kapitalin bazë të shoqërisë.
6.3. Kapitali bazë i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga Ortaku Themelues.

NENI 7
Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:
1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve - organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori - organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.



NENI 8
Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të emërohet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë riemërimi.
- 8.2. Administrator i vetëm i shoqërisë “*Solar Logistic” SHPK* do të jetë Z. *Edmond Hido*, shtetas Shqiptar, lindur më 20.08.1956 në Tiranë dhe banues në Tiranë identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me nr. Personal F60820160W madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, i cili autorizohet për të kryer të gjitha procedurat e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.3. Administratori i sipërcituar emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.4. Shoqëria do të përfaqësohet përpala çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i Shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9
Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10
Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11
Dispozitat përfundimtare

- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohej në 3 (tre) kopje në shqip dhe nënshkruhet nga Ortaku Themelues i shoqërisë.



Edmond Hido *Hido*
Përfaqësuar nga Administratori
Z. Edmond HIDO